



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE KORCE

VENDIM
Nr 108 Date 11.12.2009

Per miratimin per kalimin ne privatizim te banesave shteterore

Keshilli i Bashkise Korce, ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi mori ne analize relacionin e paraqitur nga Ndermarrja e Sherbimeve Publike, "Per kalim ne privatizim", mbeshtetur ne Ligjin Nr. 8122 date 09.07.1996 "Per miratimin pa ndryshime te dekretit te Presidentit Nr. 1440 date 04.04.1996 "Per trajtimin e banesave shteterore te paprivatizuara". Banesat shteterore qe nuk jane privatizuar deri me daten 31.12.1995 dhe qe nuk jane objekt i Ligjit 7658 date 15.04.1993 "Per kthimin dhe kompesimin e prones", kalojne ne administrimin e organeve te pushtetit lokal ne Komuna dhe Bashki, sipas vendodhjes se baneses si dhe neni 2 i cili parashikon se "Keshillat e Bashkive ose Komunave ne varesi nga vendodhja, do te vendosin per privatizimin e tyre sipas kriterëve te Ligjit Nr. 7652 date 23.12.1992 "Per privatizimin e banesave shteterore", ku sipas te cilit eshte Keshilli i Bashkise qe vendos per miratimin e kalimit ne privatizim si dhe duke u mbeshtetur dhe ne vendimin e Bashkise Korce Nr. 97 date 11.09.2000 pika 1, mbeshtetur ne kopetencat qe ka si dhe pas diskutimeve te anetareve:

VENDOSI

1 Te kaloje ne privatizim banesa ne rrugen "Mynyr Mustafaj" P 3 L 4 kati i pare, e perbere prej 2 dhoma kuzhine me sip 66.29 m², ne te cilen banon familja e **Shpatore Shahinasi**.

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Ndermarrja e Sherbimeve Publike.

3..Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI
GJERGJI PENDAVINJI